

**Për të siguruar progresin e vazhdueshëm në sistemin menaxhimit të cilësisë sipas ISO 9001:2015 Kompania i jep rendësi maksimale strukturimit të të gjitha proceseve nëpërmjet angazhimit maksimal të personelit të saj.**

Objektivat e mëposhtme janë përdorur si udhëzues për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në Kompani :

- Të menaxhojë veprimtaritë dhe burimet e lidhura me to, si një proces;
- Të identifikojë, kuptojë dhe menaxhojë proceset e ndërlidhura me to, si një sistem;
- Të jetë prioritet siguria e kushteve ambjentale dhe punonjësve tanë në punë, për tu ndjekur nga zhvillime pozitive në sektorë të ndryshëm në kompani, për të përmbushur kërkesat e shprehura dhe pasprehura të klientëve tanë, nëpërmjet "minimizimit të kostos dhe ofrimit të produkteve dhe shërbimeve cilësore",
- Të përdorë Sistemin e Cilësisë si një bazë për përmirësim të vazhdueshëm të organizimit të kompanisë dhe çështjet operationale;
- Të ruajë reputacionin dhe emrin e mirë të kompanisë, duke ofruar prodhime dhe shërbime të cilësisë së lartë, duke pasqyruar kërkesat e standardeve përkatëse si dhe të legjislacionit ekzistues në fuqi;
- Të kuptojë kërkesat dhe pritshmëritë e mundshme të klientit tonë dhe për t'iu përgjigjet atyre sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Të përmirësojë cilësinë duke zvogëluar kostot e prodhimeve dhe shërbimeve nëpërmjet projektimit, teknologjisë së përparuar dhe inovative;
- Të mbajë një nivel të mirë vlerësimi të vazhdueshëm nga klientët e saj pa çënuar cilësinë, duke rritur kënaqësinë e klientëve të kompanisë nga komunikimi efektiv dhe duke reaguar në kërkesat dhe ankesat e tyre.
- Të zbatojë kriteret e Direktivës **2014/31/EU NAWI** për të lancuar në treg Produkte të cilësisë më të lartë dhe konform standardeve Europiane.
- Të kontribuojë sadopak në përmirësimin ndaj ndryshimeve klimatike, nëpërmjet plotësimit të kërkesave të nevojshme mbi mbrojtjen dhe uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, gjatë proceseve të ndryshme të punës në kompani.

Askush në botë nuk mund të ofrojë një prodhim ose shërbim më të lirë, pa ulur cilësinë. Kompania jonë do të bazohet vetëm te cilësia me çmime të arsyeshme.

**Administratori**

**Zamir DURBAKU**

